

Kodi i Qeverisjes Korporative

Përmbajtja

<i>Parathënie</i>	3
<i>Hyrje</i>	4
<i>Terminologjia</i>	6
<i>Kapitulli I. Të drejtat e aksionarëve dhe palëve të interesit</i>	8
I.A. Ushtrimi i të drejtave të pronësisë së aksionarëve.....	8
I.B Mbajtja e mbledhjeve të përgjithshme dhe të jashtëzakonshme të aksionarëve.....	9
I.C Të drejtat e aksionarëve në vendimet themelore.....	10
I.D Të drejtat dhe përgjegjësitë e aksionarëve institucionale.....	11
I.F Të drejtat dhe prerogativat e grupeve të interesit.....	12
<i>Kapitulli II. Përbërja dhe përgjegjësitë e menaxhimit</i>	13
II.A Përgjegjësitë e Ekzekutivëve të Lartë.....	13
II.B Funksionet e Menaxhimit të Rrezikut dhe Auditimit të Brendshëm.....	14
<i>Kapitulli III. Struktura dhe Përgjegjësitë e Bordit</i>	16
III.A. Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit.....	16
IIIB. Struktura e bordit dhe komiteteve të tij.....	17
IIIC. Përbërja dhe struktura e komiteteve të bordit.....	18
IIID. Mbajtja e takimeve të bordit.....	19
IIIE. Rritja e efektivitetit të bordit.....	20
<i>Kapitulli IV. Shpalosja e informacioneve dhe transparencë</i>	21
IVA. Qasja e aksionarit në informacione.....	21
IVB. Deklarata e qeverisjes korporative.....	22
IVC. Marrëdhëniet me aksionarët.....	23
<i>Kapitulli V. Etika dhe strukturat dhe praktikat e integritetit</i>	24
VA. Roli i bordit dhe menaxhimit në promovimin e etikës.....	24
VB. Menaxhimi i konflikteve të interesit.....	25
VC. Transaksionet e palëve të lidhura dhe me rrezik të lartë.....	25

Parathënie

Hyrje

Rëndësia e qeverisjes së mirë korporative si një shtyllë integrale e qëndrueshmërisë së korporatave dhe një mekanizëm për të mbështetur besimin ndërmjet korporatave, rregullatorëve, qeverive, aksionarëve dhe palëve të interesit është e njohur globalisht. Në të gjithë botën, politikëbërësit dhe rregullatorët kanë vendosur konceptet dhe praktikët kryesore të qeverisjes korporative në ligjet dhe rregulloret kombëtare për të mbështetur miratimin e praktikave të mira të qeverisjes.

Në Kosovë, ky udhëtim arriti një pikë të rëndësishme me rishikimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në vitin 2018, i cili mbanë një numër konceptesh të rëndësishme të qeverisjes korporative në ligjin kombëtar. Për më tepër, neni 9 i ligjit parashikon gjithashtu që "Ministri miraton një Kod të Qeverisjes Korporative, duke përfshirë dispozitat për monitorimin dhe zbatimin e këtij Kodi".

Dokumenti aktual është një manifestim i kësaj kërkesë, duke u mbështetur në standardet ekzistuese të qeverisjes korporative tashmë në Kosovë. Përderisa nuk ka ende standarde specifike të qeverisjes për kompanitë e listuara në Kosovë si në vendet me një treg ekzistues të kapitalit, bankat dhe ndërmarrjet e sektorit publik tashmë adresohen nga rregulloret e veçanta të qeverisjes korporative, të nxjerra përkatësisht në vitin 2014 dhe 2016.

Derisa politikëbërësit po punojnë në zhvillimin e mëtejshëm të kornizës ligjore kombëtare dhe përafrimin e tij me praktikët më të mira të Bashkimit Evropian, nevojiten përpjekje shtesë për të promovuar qeverisjen e mirë. Këto përpjekje janë veçanërisht të rëndësishme ndërmjet ndërmarrjeve të mëdha që kanë aftësinë për të vendosur protokolle më të fuqishme të qeverisjes dhe të cilat janë gati të përfitojnë prej tyre brenda dhe në ndërveprimet e tyre me palët e interesit.

Kodi është i bazuar dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare të pasqyruara në Parimet e G20 të OECD për Qeverisjen Korporative, të përditësuara për herë të fundit në vitin 2015, si dhe *acquis* dhe standardet përkatëse të Bashkimit Evropian në juridiksionet homologe.¹ Është gjithashtu në përputhje me parimet e qeverisjes të zbatueshme për bankat dhe ndërmarrjet e sektorit publik në Kosovë, megjithëse këto të fundit përjashtohen nga fusha e zbatimit të saj pasi rregullohen veçmas.

Përderisa të gjitha ndërmarrjet e regjistruara në Kosovë inkurajohen të miratojnë rekomandimet e tij, ky Kod posaçërisht ka për qëllim "ndërmarrjet e mëdha" siç përcaktohet në Nenin 5 të Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim nga të cilat kërkohet të miratojnë dispozitat e këtij Kodi mbi bazën "pajtohu ose shpjego".

Ndërsa autorët pranojnë që jo të gjitha dispozitat e këtij Kodi mund të jenë të rëndësishme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe ata inkurajohen të miratojnë ato rekomandime përkatëse që do të ndikojnë në rritjen e efikasitetit të strukturës së tyre të qeverisjes korporative. Në veçanti, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që kanë aksionarë të jashtëm mund të marrin në konsideratë miratimin e mekanizmave që ndikojnë rritjen e besimit tek ta. Nga ana tjetër, bankat dhe

¹ Përfshirë këtu veçanërisht DIREKTIVËN (BE) 2017/828, RREGULLOREN (BE) 2018/1212, Planin e Veprimit të Komisionit për Rritjen e Qëndrueshme, si dhe Udhëzimet e Qeverisjes Korporative dhe Parimet për Kompanitë e Regjistruara në Evropë të lëshuara nga ECODA në 2010.

kompanitë në pronësi publike² do të rregullohen veçmas përmes udhëzimeve ekzistuese të korporatave të zbatueshme për to dhe kështu nuk i nënshtrohen këtij Kodi.

Ndërmarrjet të huaja të mëdha (sipas të njëjtit përkufizim të Ligjit për Kontabilitetin), gjithashtu do t'u kërkohej të miratojnë rekomandimet e Kodit.³ Si të tillë, atyre do t'u kërkohej të lëshojnë një Deklaratë të Qeverisjes Korporative. Kompanitë që kanë miratuar tashmë një kod/rekomandime të brendshme të qeverisjes korporative duhet të raportojnë vetëm për çështjet e mbuluara nga ky Kod, që Kodi ose Rregullorja e tyre e brendshme nuk adreson.

Duke marrë parasysh fazat e hershme të zhvillimit të praktikave të qeverisjes korporative në vend, Kodi do të aplikohet si një standard vullnetar për një vit pas botimit të tij. Kjo kohë ka për qëllim të lejojë kompanitë të përshtatin kornizat e tyre të qeverisjes për të pasqyruar rekomandimet e tyre. Duke filluar nga viti 2022, Këshilli i Kosovës për Raportimin Financiar do të jetë institucioni mbikëqyrës dhe përgjegjëse në zbatimin e pajtueshmërisë së kompanive me të.

Për vitin fiskal që përfundon në vitin 2022, "ndërmarrjet e mëdha" siç përcaktohet në Ligjin për Kontabilitet dhe Raportim Financiar do të bëjnë një shpjegim në raportin e tyre vjetor se si i përmbahen dispozitave të këtij Kodi mbi bazën pajtohu ose shpjego. Kjo zgjeron dispozitën ekzistuese të Ligjit për Shoqëritë Tregtare (Neni 7) i cili kërkon që kompanitë e mëdha të përgatisin një Deklaratë të Qeverisjes Korporative, duke përfshirë "informacionin mbi qeverisjen korporative, përsëritjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, përbërjen, menaxhimin e organeve menaxheriale, mbikëqyrëse dhe komiteteve të tyre".

Ky Kod synon të nxjerrë në pah praktikën më të mirë për t'u ndjekur në këto fusha dhe të sigurojë një bazë për kompanitë që të paraqesin strukturat e tyre të qeverisjes në Deklaratën e Qeverisjes Korporative. Deklarata e Qeverisjes Korporative do të përshkruajë veçanërisht çdo shmangje nga miratimi i dispozitave të këtij Kodi, duke përshkruar arsyetimin për këto ndryshime dhe çdo veprim korrigjues që do të miratohet.

Në vazhdim, drejtuesit dhe bordet duhet të marrin në konsideratë mekanizmat e duhur për të integruar rekomandimet e këtij Kodi në kornizat e qeverisjes korporative. Ata mund ta bëjnë këtë duke reflektuar rekomandimet e këtij Kodi në statutin dhe rregulloret e shoqërisë, si dhe në dokumente jo-detyruese të tilla si kodi specifik i qeverisjes dhe etikës së kompanisë ose një udhëzues bordi. Duke vepruar kështu, ata gjithashtu do t'i referohen legjislacionit përkatës të korporatave i cili adreson çështjet e qeverisjes korporative.

Përgjegjësia për zbatimin e këtyre udhëzimeve u takon organeve të ndryshme të qeverisjes, duke përfshirë bordin, menaxhmentin e lartë si dhe marrëdhëniet e investitorëve. Kështu, zbatimi i këtyre praktikave kërkon një alokim të qartë të përgjegjësisë të qeverisjes për organet përkatëse të kompanisë në nivelin e bordit dhe ekzekutivit.

Ky Kod do të zhvillohet së bashku me zhvillimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në qeverisjen korporative dhe në përputhje me zhvillimet përkatëse ekonomike dhe të korporatave

² Përfshirë këtu Ndërmarrjet në pronësi publike, në pajtim me ligjin në fuqi për Ndërmarrjet Publike ashtu edhe Ndërmarrjet Shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, sipas emërimit në Nenin 23 të Ligjit për Kompanitë.

³ Këto përfshijnë degët e organizatave të huaja të biznesit dhe zyrat përfaqësuese të organizatave të huaja të biznesit në Kosovë sipas emërimit në nenin 23 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

në Kosovë. Këshilli i Kosovës për Raportimin Financiar do të monitorojë këto zhvillime dhe do të marrë në konsideratë çdo rishikim të nevojshëm të këtij Kodi.

Terminologjia

Termet dhe shprehjet e përdorura në këtë Kod do të kenë kuptimin si në vijim:

Drejtori i Bordit/Drejtori i Kompanisë: Një anëtar i bordit të drejtorëve të një kompanie, përfshirë anëtarët ekzekutivë dhe jo-ekzekutivë të bordit.

Kodi: Ministri nxjerr Kodin e Qeverisjes Korporative, së bashku me dispozitat për monitorimin dhe zbatimin e këtij kodi. Kodi i Qeverisjes Korporative miratohet në formë të udhëzuesit dhe nuk përbën akt ligjor.

Interesi kontrollues: Aftësia për të ndikuar në veprimet ose vendimet e ndërmarrjes në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, duke zotëruar 50% ose më shumë të të drejtave të votimit në një kompani ose duke pasur të drejtën për të emëruar 50% ose më shumë të bordit. Kompanitë me pronësisë të shpërndarë të aksioneve mund të kontrollohen edhe nga aksionaret që kanë në pronësi me pak aksione.

Ligji për Shoqëritë Tregtare: Ligji Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare i miratuar më 24 maj 2018 nga Qeveria e Kosovës.

Korporata: një shoqëri aksionare ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Kosovë.

Qeverisja Korporative: Përfshinë një grup marrëdhëniesh në mes të menaxhmentit të një kompanie, bordit të drejtorëve, aksionarëve dhe akterëve të tjerë të interesuar, duke siguruar strukturën përmes së cilës vendosen objektivat e kompanisë dhe përcaktohen mjetet për arritjen e këtyre objektivave.

Sekretari i Korporatës: Një zyrtar i lartë i emëruar nga bordi i drejtorëve, përgjegjës për mbështetjen e Kryesuesit të Bordit në lehtësimin e ndërveprimeve rutinë të bordit, si dhe aktivitete ad hoc siç janë vlerësimet e bordit dhe trajnimi.

Votimi kumulativ: një metodë e zgjedhjes së anëtarëve të bordit që i jep secilit aksionar një të drejtë votimi ekuivalent me numrin e aksioneve që ai/ajo zotëron, dhe me të cilën aksionari ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e tij/saj te votimit drejt një të nominuari ose të ndajë votat e të tij/saj ndaj disa të nominuarve.

Auditimi i brendshëm: është një aktivitet i pavarur, kontroll objektiv dhe këshillim i krijuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar operacionet e një shoqërie tregtare.

Marrëdhëniet me investitorët: Një funksion i cili synon të mbështesë komunikimin efektiv midis një kompanie dhe investitorëve të saj aktualë dhe potencialë dhe akterëve të tjerë të interesit që integron financat, komunikimin, marketingun, letrat me vlerë, kompetencat ligjore dhe të pajtueshmërisë.

Drejtori Ekzekutiv: një anëtar i Bordit me kohë të plotë i ekipit ekzekutiv të menaxhimit të kompanisë dhe merr pjesë në aktivitetet e saj të përditshme.

Kompanitë e huaja: një degë e regjistruar në Kosovë për të ushtruar veprimtari të ligjshme biznesi për një organizatë të huaj biznesi të krijuar në bazë të ligjit të një juridiksioni jashtë Kosovës.

Kompania e madhe: Sipas Ligjit Nr. 06/L -032 për Kontabilitet dhe Raportim Financiar, ndërmarrjet/grupet e mëdha janë ato që tejkalojnë kufijtë e të paktën 2 prej tre kritereve të mëposhtëm: pasqyra e pozicionit financiar prej njëzet milion eurosh; qarkullim neto prej dyzet milion eurosh; më shumë se 250 numri i të punësuarve gjatë vitit financiar.

Kryesuesi i Drejtorëve të Pavarur: është një drejtor i pavarur i caktuar nga bordi për të shërbyer në kapacitetin e liderit për të koordinuar aktivitetet e drejtorëve të tjerë të pavarur.

Ministria: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e cila ishte përgjegjëse për hartimin e këtij Kodi.

Drejtori jo-ekzekutiv: një anëtar i Bordit i cili nuk është anëtar me kohë të plotë i ekipit menaxhues të Kompanisë dhe nuk merr pjesë në aktivitetet e tij të përditshme.

Drejtori i Pavarur: një anëtar jo-ekzekutiv i Bordit i cili gëzon pavarësi të plotë në pozicionin e tij / saj nga menaxhmenti dhe aksionarët.⁴

Menaxhmenti ekzekutiv: personat përgjegjës për menaxhimin strategjik të ndërmarrjes, të cilët mund të përfshijë Kryeshëfën Ekzekutiv, Zyrтарin e Lartë Financiar, Zyrтарin e lartë për Auditim, Zyrтарin e Lartë Operativ, Zyrтарin e Lartë për Menaxhimin e Riskut dhe të tjerët siç kërkohet.

Kuvendi i aksionarëve: një kuvend i përbërë nga aksionarë të ndërmarrjeve i formuar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Palët e interesit: çdo person që ka një investim financiar në ndërmarrje, përfshirë punonjësit, kreditorët, klientët, furnitorët dhe komunitetin.

Aksionarët e rëndësishëm: çdo person/entitet i cili zotëron (5%) ose më shumë të aksioneve të kompanisë ose të drejtat e votës në të.

Palët e përfshira: çdo person ose entitet që ka lidhje me njësinë raportuese sipas përkufizimit të përfshirë në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 24.⁵

Shpërblimi: kompensim fiks dhe i ndryshueshëm i marrë nga drejtuesit dhe anëtarët e bordit. Për menaxhmentin mund të përbëhet nga pagesa fikse dhe e ndryshueshme; për anëtarët e bordit nga tarifa bazë.

⁴ Përkufizimi i saktë sipas nenit 168 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

⁵ <https://www.ifrs.org/issued-standards/list-of-standards/ias-24-related-party-disclosures/>

Kapitulli I. Të drejtat e aksionarëve dhe palëve të interesit

Aksionaret kryesorë të korporatave si akterë kryesor të qeverisjes duhet të kenë një rol të rëndësishëm në lidhje me çështjet korporative. Sidoqoftë, nga perspektiva ligjore, ata nuk kanë kompetence të drejtpërdrejtë për të monitoruar operacionet e kompanisë, përgjegjësi e cila i takon bordit dhe menaxhmentit. Të drejtat e tyre për të ndikuar në punët korporative janë përgjithësisht indirekte, duke përfshirë të drejtën për të ndikuar në zgjedhjen e anëtarëve të bordit, për të ndryshuar dokumentet themeluese të kompanisë dhe për të miratuar transaksione të jashtëzakonshme.

Ushtrimi efektiv i të drejtave të aksionarëve është thelbësor për funksionimin e duhur të sistemit të qeverisjes korporative. Është e rëndësishme që korniza e qeverisjes korporative të mbrojtë dhe lehtësojë ushtrimin efektiv të të drejtave të aksionarëve dhe të sigurojë trajtimin e tyre të barabartë. Mbrojtja e të drejtave të aksionarëve është e një rëndësie të veçantë për kompanitë me aksionarë të jashtëm ose aksionarë të vegjël, ku mund të lindin rreziqe të abuzimit të aksionarëve të vegjël.

Ky seksion i Kodit adreson ushtrimin efektiv të të drejtave të aksionarëve, duke ofruar udhëzime për ndërmarrjet se si t'i përfshijnë të drejtat e aksionarëve në kornizën e qeverisjes dhe se si t'i mbrojnë ato. Rekomandimet e mëposhtme bazohen në dispozitat ekzistuese të Ligjit për Shoqëritë Tregatë, duke ofruar udhëzime të mëtejshme mbi ushtrimin e të drejtave të aksionarëve, të drejtat dhe përgjegjësitë e investitorëve institucionalë, sjelljen e kuvendeve të përgjithshme dhe të drejtat e aksionarëve në vendimet themelore.

Është e rëndësishme që këto rekomandime të interpretohen në kontekstin e strukturës së pronësisë së korporatës, veçanërisht ndaj investitorëve të jashtëm ose të vegjël, të cilët përballen me rreziqe të veçanta. Përderisa kompanitë mund të kenë nevojë të rishikojnë dokumentet e tyre themelore të korporatave siç janë statutet e shoqatës për të siguruar që këto të drejta pasqyrohen në mënyrë adekuate, rekomandohet që korniza e miratuar të jetë fleksibile, duke i lejuar kompanitë të bëjnë rregullime sipas kërkesës.

I.A. Ushtrimi i të drejtave të pronësisë së aksionarëve

Kompanitë duhet të sigurojnë që të drejtat themelore të aksionarëve të adresohen në kornizën e tyre të qeverisjes, dhe të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi.⁶

Këto përfshijnë të drejtën për të siguruar metodat e regjistrimit të pronësisë; të përcjellë ose transferojë aksione; të marrin informacione relevante dhe materiale në baza të rregullta dhe me kohë; marrin pjesë dhe votojnë në mbledhjet e përgjithshme të aksionarëve; zgjedhin dhe heqin anëtarët e bordit; dhe të ndajnë fitimet e korporatës.

Aksionarët duhet të aftësohen dhe inkurajohen të ushtrojnë zërin e tyre në kuvendet vjetore të aksionarëve duke përdorur parimin e një anëtar një votë, i cili mundëson që zëri i tyre të dëgjohet në proceset e vendimmarrjes së ndërmarrjes.⁷

⁶ Ju lutemi referojuni Ligjit për Shoqëritë Tregatë i cili tashmë adreson këto çështje themelore, duke siguruar udhëzime specifike për të drejtat e pronësisë së aksionarëve për lloje të ndryshme për ndërmarrjet.

⁷ Sidoqoftë, ndryshe nga juridiksionet e tjera, Ligji për Shoqëritë Tregatë parasheh që një aksion të jetë në pronësi të më shumë se një aksionari në kompani të caktuara (neni 91). Sidoqoftë, përveç nëse Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar parashikon ndryshe, të gjithë bashkëpronarët e një Aksioni do të ushtrojnë votën e tyre dhe

Të gjithë aksionarët e së njëjtës klasë duhet të kenë të drejta të barabarta.⁸ Aksionarët e preferuar mund të përfitojnë nga të drejtat shtesë siç janë shënuar në dokumentet themeluese të shoqërisë, për sa kohë që kjo respekton parimet themelore të kapitalit aksionar.

Kompanitë duhet të mbajnë një regjistër të azhurnuar të aksionarëve të tyre të të gjitha klasave dhe t'i lejojnë aksionarët të kenë qasje në regjistrat e ndërmarrjeve.

Dokumentet në lidhje me mbajtjen e mbledhjeve të kaluara të aksionarëve dhe vendimet e miratuara do t'u vihen në dispozicion të gjithë aksionarëve.

I.B Mbajtja e mbledhjeve të përgjithshme dhe të jashtëzakonshme të aksionarëve

Kompanitë do të organizojnë një Mbledhje të Përgjithshme Vjetore (MPV) të zakonshme një herë në vit. Modalitetet për organizimin e një asambleje të përgjithshme vjetore të aksionarëve janë të përshkruara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Veçanërisht, mbledhjet vjetore të aksionarëve do të mbahen brenda tridhjetë (30) ditësh pasi bordi të marrë pasqyrat financiare të audituara të kompanisë, por jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas përfundimit të fundit të vitit financiar.

Bordi i drejtorëve do të jetë përgjegjës për sigurimin e mbajtjes në kohë të mbledhjes vjetore të aksionarëve, në përputhje me legjislacionin përkatës dhe dispozitat në dokumentet e themelimit të shoqërisë.

Aksionarët duhet të kenë mundësinë të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të votojnë në mbledhjet e përgjithshme të aksionarëve dhe duhet të informohen për rregullat, përfshirë procedurat e votimit që rregullojnë këto.

Aksionarët duhet të pajisen me informacion të mjaftueshëm dhe në kohë në lidhje me datën, vendndodhjen dhe agjendën e mbledhjeve të përgjithshme, si dhe informacion të plotë dhe me kohë në lidhje me çështjet që do të vendosen në mbledhje.

Me kusht që të jetë në përputhje si më sipër, statuti i kompanisë ose aktet nënligjore ose dokumente të tjera qeverisëse mund të specifikojnë datën dhe kohën e saktë, ose një metodë për përcaktimin e datës dhe orës së saktë, për mbajtjen e mbledhjes vjetore.

Si e tillë, asambleja e aksionarëve do të mbahet në vendin e përcaktuar në dokumentet qeverisëse të shoqërisë ose në një vend të caktuar nga bordi i drejtorëve. Qëllimi duhet të jetë lehtësimi i pjesëmarrjes së numrit më të madh të aksionarëve.

Gjatë MPV, aksionarët duhet të kenë mundësinë t'i bëjnë pyetje bordit dhe menaxhmentit dhe të propozojnë rezoluta në lidhje me rrjedhën e biznesit të kompanisë.

të drejtat e tjera në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar vetëm përmes një përfaqësuesi të vetëm të përbashkët, por ata janë bashkërisht dhe veçmas përgjegjës për të gjitha detyrimet që respektojnë Aksionin.

⁸ Veçanërisht, të gjitha aksionet e së njëjtës klasë do të kenë të drejtë në të njëjtën shpërndarje të dividendit.

Aksionarët duhet të jenë në gjendje të votojnë personalisht ose në mungesë, dhe efekti i barabartë duhet t'u jepet votave qoftë të dhëna personalisht ose në mungesë. Aksionarët e huaj duhet të jenë në gjendje të japin votat e tyre pa ndonjë pengesë edhe nëse votojnë përmes ndërmjetësve.

Votimi elektronik në mungesë, përfshirë shpërndarjen elektronike të materialeve të përfaqësimit dhe sistemin e besueshëm të konfirmimit të votave, duhet të lehtësohet, veçanërisht nga kompanitë me aksionarë të huaj.⁹

Bordi i drejtorëve do të sigurojë që aksionarëve t'u sigurohen pasqyrat financiare të audituara dhe dokumentet e tjera përkatëse të paktën tridhjetë ditë para MPVse.

Aksionarët duhet të jenë në gjendje të paraqesin pyetje në lidhje me pasqyrat financiare dhe raportin e auditimit të jashtëm, përfshirë auditorët që duhet të marrin pjesë në MPV dhe të jenë në dispozicion për t'iu përgjigjur pyetjeve.

Aksionarët caktojnë bordin e drejtorëve dhe miratojnë shpërblimin e tij. Veçanërisht, skemat e kompensimit për anëtarët e bordit dhe drejtuesit duhet t'i nënshtrohen miratimit të aksionarëve.

Aksionarët do të kenë të drejtë të shtojnë pika në rendin e ditës në mbledhjet vjetore të kompanisë për sa kohë që ato janë të rëndësishme për çështjet e kompanisë.

Dokumentet e themelimit të kompanisë mund të specifikojnë më tej një numër minimal të aksionarëve të kërkuar për të sponsorizuar një rezolutë të specifikuar si përqindje e vlerës së tregut ose të drejtave të votës.¹⁰

Bordit do t'i lejohet të thërrasë takime të jashtëzakonshme të aksionarëve sipas dispozitave të specifikuara në Ligjin e Kosovës për Shoqëritë Tregtare.

Mbledhjet e jashtëzakonshme të aksionarëve mund të thirren nga bordi i drejtorëve ose nga aksionarët që zotërojnë të paktën dhjetë për qind (10%) të kapitalit të shoqërisë.¹¹

I.C Të drejtat e aksionarëve në vendimet themelore

Të gjithë aksionarët e së njëjtës klasë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë. Të gjithë investitorët duhet të jenë në gjendje të marrin informacion në lidhje me të drejtat e bashkangjitura në të gjitha seritë dhe klasat e aksioneve para se t'i marrin ato.

Strukturat dhe rregullimet e kapitalit që u mundësojnë aksionarëve të marrin një shkallë të ndikimit ose kontroll jo proporcional me pronësinë e tyre të kapitalit duhet të zbulohen (të dihen).

⁹ Ligji për Shoqëritë Tregtare tashmë parashikon që statuti i një Shoqërie Aksionare mund të parashikojë që aksionarët mund të marrin pjesë në një asamble të aksionarëve në një komunikim elektronik ose telefonik, ose ndonjë komunikim tjetër në distancë (neni 184).

¹⁰ Duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

¹¹ Ligji i Kosovës për Shoqëritë Tregtare gjithashtu parashikon që në disa raste Drejtorin Menaxhues / Kryeshefin Ekzekutiv gjithashtu mund të ju lejohet të thërrasin një takim.

Të drejtat e bashkangjitura në klasa të ndryshme të aksioneve nuk do të ndryshohen përveç me miratimin paraprak të aksionarëve (nga një shumicë e thjeshtë e aksionarëve të asaj klase të ndikuar negativisht).

Rregullat dhe procedurat që rregullojnë blerjen e kontrollit të korporatave dhe transaksionet e jashtëzakonshme duhet të zbulohen qartë në mënyrë që investitorët të kuptojnë të drejtat e tyre.

Transaksionet duhet të ndodhin me çmime transparente dhe në kushte të drejta që mbrojnë të drejtat e të gjithë aksionarëve sipas klasës së tyre.

Strategjitë kundër përvetësimit të aksionareve të vegjël ("poison pills") nuk duhet të përdoren për të mbrojtur menaxhimin dhe bordin nga përgjegjësia, dhe bordet duhet të ushtrojnë kujdesin e duhur në miratimin e ndonjë strategjie të tillë.

Aksionarët të cilët, vetëm ose së bashku me palët e lidhura, zotërojnë më shumë se pesëmbëdhjetë për qind (15%) të aksioneve të zakonshme të një kompanie me më shumë se njëqind (100) mbajtës të aksioneve të zakonshme, do të njoftojnë menjëherë Kompaninë për këtë fakt dhe çdo të drejtë që përfitojnë nga ky bllok kontrolli të aksioneve.¹²

Sigurimi i të drejtave shtesë të aksionarëve afatgjatë gjithnjë e më shumë konsiderohet si një praktikë e mirë e qeverisjes korporative. Kompanitë mund të sigurojnë mekanizmat për të promovuar pronësinë afatgjatë të aksioneve.

Në kompanitë e kontrolluara, rregulloret e qeverisjes korporative të kompanisë mund të përcaktojnë të drejta dhe përgjegjësi të veçanta për kontrollimin e aksionarëve për të siguruar që ndikimi i tyre në punët e kompanisë nuk është i tepruar.¹³

I.D Të drejtat dhe përgjegjësitë e aksionarëve institucionalë

Investitorët institucionalë, përfshirë fondet e pensioneve dhe fondet të përbashkëta, dhe kompanitë e sigurimeve, si private ashtu edhe publike, duhet të kenë dijeni për përgjegjësitë e tyre të administrimit.¹⁴

Investitorët institucionalë duhet të përpiqen të zhvillojnë politikat e pronësisë dhe administrimit, në të cilat përshkruajnë pritjet e tyre si investitorë.

Politikat e tilla mund të përfshijnë strategjitë e tyre të angazhimit, qasjen(et) që do të përdoren për ndërhyrje të tilla, dhe mënyrën se si ata do të vlerësojnë efektivitetin e këtyre angazhimeve.

¹² Për informacion të mëtejshëm mbi procedurat e sakta, referojuni nenit 208 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

¹³ Për shembull, kur një kompani mund të hyjë në një transaksion të rëndësishëm me një aksioner kontrollues, rekomandohen kontrolle dhe ekuilibra shtesë dhe zbulimi në kohë i këtyre transaksioneve.

¹⁴ Ndryshimi i fundit i Parimeve të G20 të OECD për Qeverisjen Korporative dhe standardet kombëtare që e ndoqën atë përfshijnë përgjegjësi specifike të administrimit mbi investitorët institucionalë.

Investitorët institucionalë që veprojnë në një kapacitet fiduciar duhet të shpalosin qeverisjen e tyre korporative dhe politikat e votimit, përfshirë mënyrën se si ata menaxhojnë konfliktet materiale të interesit.

Investitorët institucionalë duhet të votojnë në kuvendet e aksionarëve në përputhje me politikat e tyre të votimit dhe të vendosin një dialog të vazhdueshëm me kompanitë e portofolios.

Për ta bërë këtë, rekomandohet që investitorët institucionalë të kenë burime të mjaftueshme të dedikuara për të rishikuar qeverisjen korporative të kompanive të tyre në të cilat kanë investuar, veçanërisht në kompanitë e regjistruara në Kosovë.

Aksionarët institucionalë mund të publikojnë rezultatet të pronësisë dhe strategjive të tyre të angazhimit në një raport vjetor.

Raporte të tilla mund të përfshijnë natyrën dhe numrin e angazhimeve, rezultatet e këtyre angazhimeve dhe pikëpamjet e tyre mbi ndryshimet e tregut.

Institucionet përgjegjëse që mbajnë letrat me vlerë si të nominuar nuk duhet të hedhin votat në ato letra me vlerë nëse nuk kanë marrë autorizim për ta bërë këtë.

Nga ana tjetër, aksionarët përfitues inkurajohen të komunikojnë vendimet e tyre për votim tek ndërmjetësit e tregut financiar.

Edhe pse investitorët institucionalë mund të përdorin këshillat e këshilltarëve të autorizuar dhe burimeve të tjera të informacionit specifik të kompanisë, ata nuk do t'ua delegojnë përgjegjësinë e tyre të administrimit këtyre njësive.

I.F Të drejtat dhe privilegjet e grupeve të interesit

Korniza ligjore dhe rregullative në Kosovë njeh të drejtat e palëve të interesit¹⁵ dhe synon të inkurajojë bashkëpunimin midis korporatave dhe palëve të interesit në krijimin e pasurisë, punësimit dhe qëndrueshmërisë së korporatave.

Kompanitë që krijojnë sisteme të qeverisjes dhe i kodifikojnë ato në kodet e qeverisjes do të adresojnë të drejtat e palëve të interesit dhe angazhimet e bordit dhe menaxhmentit ndaj komunitetit të palëve të interesit.

Deklarata e Qeverisjes Korporative do të zbulojë çdo vendim që prek ndjeshëm të drejtat e palëve të interesit ose ndonjë ankesë të rëndësishme të paraqitur nga palët e interesit.

Për aq sa punonjësit e ndërmarrjes lejohen të emërojnë një përfaqësues të bordit, procedurat rreth emërimit dhe zgjedhjes së tyre duhet të jenë të qarta. Përfaqësuesit e punonjësve do të kenë të drejta të barabarta në borde, përfshirë veçanërisht për sa i përket të drejtës së votimit.

¹⁵Të drejtat specifike të palëve të interesit janë veçanërisht të përfshira në Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Rregullat e qeverisjes korporative për bankat dhe ndërmarrjet e sektorit publik adresojnë gjithashtu të drejtat e kreditorëve dhe punonjësve për sa kohë që këta të fundit ftohen të marrin pjesë në borde.

Kapitulli II. Përbërja dhe përgjegjësitë e menaxhimit

Përgjegjësia për zbatimin e strategjisë së korporatave vendoset në duart e ekipit menaxhues të zgjedhur, të motivuar dhe, kur është e nevojshme, të zëvendësohet nga bordi. Përgjegjësia e ekipit menaxhues për përcaktimin dhe ekzekutimin e strategjisë së korporatës, menaxhimin e rrezikut, auditimin dhe funksione të tjera mbikëqyret nga bordi.

Duke vepruar kështu, bordi në mënyrë efektive i delegon menaxhmentit detyrat e tij për ekzekutimin e përditshëm të strategjisë së korporatave, një organ i tretë i qeverisjes korporative, pas aksionarëve dhe bordit. Si rezultat, menaxhmenti ekzekutiv ka përgjegjësinë për qeverisjen e brendshme të punëve të korporatave dhe disponon informacionin më të plotë në lidhje me sfidat strategjike, operacionale dhe progresin.

Korniza e qeverisjes korporative duhet të krijojë një nivel të duhur të kompetencave ekzekutive që do t'i delegohen menaxhmentit. Nëse jepet shumë pak fuqi dhe liria e veprimit e menaxhmentit është shumë e kufizuar, kompania ka të ngjarë të bëhet jo fleksibile. Sidoqoftë, me kompetenca të tepruara të menaxherëve interesat e aksionarëve mund të cenohen.

Ekipi i menaxhimit do të emërohet nga bordi ose një komitet i tij siç është Komiteti i Emërimit dhe Shpërblimit, pasi të jetë siguruar vetë për aftësinë e tyre për të drejtuar korporatën. Shpërblimi i menaxhimit përcaktohet gjithashtu nga bordi me qëllim që të harmonizojë qëllimet e menaxhimit me objektivat afatgjatë të korporatave, duke adresuar rreziqet e mundshme të vizionit afatshkurtër.

Ekipi i menaxhmentit të lartë ka implikimin më të madh në punët korporative në baza të përditshme dhe kështu është përcaktues për qëndrueshmërinë e korporatës. Prandaj, është e nevojshme që ata të kenë aftësitë dhe njohuritë e duhura. Përbërja e menaxhmentit të lartë varet nga madhësia dhe kompleksiteti i strukturës së korporatës, zakonisht duke përfshirë Shefin Ekzekutiv (CEO), Zyrtarin Kryesor Financiar (CFO), Zyrtarin Kryesor të Operacioneve (COO), Drejtorin Kryesor Ligjor, Auditimin dhe drejtues të tjerë të lartë.

II.A Përgjegjësitë e Ekzekutivëve të Lartë

Funksioni i Burimeve Njerëzore do të mbajë një profil të azhurnuar për secilin rol të menaxhimit dhe do të marrë në konsideratë të drejtën e planifikimit të trashëgimisë për rolet kryesore.

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve të lartë do të përshkruhen në kodin e qeverisjes së kompanisë ose ekuivalentin e tij.¹⁶

Anëtarët e menaxhmentit të lartë duhet të kenë përvojën, kompetencat dhe integritetin e duhur për të menaxhuar bizneset dhe njerëzit nën mbikëqyrjen e tyre.

Ata duhet të kenë qasje në trajnime adekuate në mënyrë që të rrisin njohuritë e tyre që të jenë të përgatitur për zhvillimet që lidhen me fushën e tyre të përgjegjësisë.

¹⁶ Kompetencat specifike të një Kryeshefi Ekzekutiv/Drejtorit Menaxhues janë përshkruar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Përmbledhja e përgjegjësive dhe linjat e raportimit të drejtuesve të lartë duhet të kodifikohen në grafikun organizativ për tu azhurnuar rregullisht dhe për aq sa është e mundur, gjithashtu të vihen në dispozicion publikut.

Kryeshefi Ekzekutiv do të krijojë dhe vë në dispozicion të palëve përkatëse një delegim të autoritetit të tij që të ketë qartësi në lidhje me nënshkruesit e autorizuar, si dhe kontrolle për t'ju shmangur mashtrimeve.

Procesi i përzgjedhjes së CEO dhe drejtuesve të lartë, si dhe monitorimi i performances së tyre është përgjegjësi e bordit ose e një komiteti të dedikuar prej tij (p.sh. Qeverisja ose Komiteti i Emërimit dhe Kompensimit).

Procesi i përcaktimit të shpërblimit ekzekutiv është gjithashtu përgjegjësi e bordit ose një komiteti të tij, p.sh. Komitetit të Nominimit dhe Shpërblimit ose Qeverisjes.¹⁷

II.B Funksionet e Menaxhimit të Rrezikut dhe Auditimit të Brendshëm

Menaxhimi i rrezikut përfshin mbikëqyrjen e përgjegjësive për menaxhimin e rreziqeve, duke specifikuar llojet dhe shkallën e rrezikut që një kompani është e gatshme të pranojë, dhe si do t'i menaxhojë ato.

Menaxhimi efektiv i rrezikut gjithnjë e më shumë njihet si një komponent kritik i qeverisjes së mirë të korporatave dhe përfshin procese si në nivelin e ekzekutivit ashtu edhe të bordit.

Bordi do të mbikëqyrë sistemin e menaxhimit të rrezikut dhe sistemet e krijuara për të siguruar që korporata i bindet ligjeve në fuqi, duke përfshirë ligjet e taksave, konkurrencës, punës, mjedisit, mundësive të barabarta, shëndetit dhe sigurisë.

Ndërsa përgjegjësia përfundimtare për administrimin e rrezikut i takon bordit (ose një komiteti – si Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut). Është përgjegjësi e menaxhmentit të sigurojë që rreziqet e marra të jenë në koherencë me profilin e rrezikut të kompanisë.

Funksionet specifike të korporatave të tilla si menaxhimi i rrezikut dhe auditimi i brendshëm kanë një rëndësi të veçantë për të provuar sigurinë për menaxhmentin dhe bordin, duke bërë mbikëqyrjen e duhur të rreziqeve kryesore dhe saktësinë e raportimit financiar.¹⁸

Funksioni i auditimit të brendshëm është po aq i rëndësishëm për të menaxhuar rreziqet, veçanërisht qeverisjen dhe rreziqet e integritetit. Auditimi i brendshëm do të ndihmojë organizatat të përmbushin objektivat duke sjellë një qasje sistematike për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe proceseve të qeverisjes.

Në fund të fundit, bordi është përgjegjës për mbikëqyrjen e sistemit të kontrollit të brendshëm bazuar në raportet që merr nga menaxhmenti dhe direkt nga auditori i brendshëm.

¹⁷ Mund të bazohet në një standard krahasimi që do të përdoret nga bordi si një kontribut për vendimmarrjen e tij.

¹⁸ Funksioni i auditimit të jashtëm, që do të trajtohet në detaje të mëtejshme më poshtë, ofron siguri të mëtejshme në atë drejtim, duke raportuar drejtpërdrejt në bord.

Rekomandohet që funksioni i auditimit të brendshëm të drejtohet nga një Shef i pavarur i Auditimit të Brendshëm (d.m.th. Zyrtares Kryesor i Auditimit).

Menaxhmenti duhet të jetë përgjegjës për zhvillimin e programeve të auditimit të brendshëm dhe menaxhimit të rrezikut duke prezantuar këto programe për aprovim nga bordi.

Departamenti i auditimit të brendshëm do të përgatisë dhe paraqesë një raport me shkrim për aktivitetet e tij për Bordin dhe Komitetin e Auditimit.¹⁹

Bazuar në këtë raportim, bordi (ose një komitet i tij) duhet të sigurohet për integritetin e sistemeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar të korporatës, duke përfshirë auditimin e pavarur, menaxhimin e rrezikut, kontrollin financiar dhe operacional dhe pajtueshmërinë.

Ndërsa auditimi i brendshëm ndihmon organizatat të mbajnë integritetin e operacioneve të tyre, ai duhet të plotësohet nga aktiviteti i auditimit të jashtëm, që duhet të kryhet nga një auditor i jashtëm i licencuar dhe i kualifikuar, i caktuar nga bordi (d.m.th. Komiteti i tij i Auditimit).

Rolet e Zyrtares Kryesor të Riskut dhe Zyrtares Kryesor të Auditimit të Brendshëm, në masën që ato ekzistojnë, nuk duhet të kombinohen me funksione të tjera në kompani.²⁰

Departamentet e rrezikut, pajtueshmërisë dhe auditimit të brendshëm duhet të pajisen me burimet e nevojshme financiare për të kryer detyrat e tyre. Kjo duhet të jetë objekt diskutimi me menaxhmentin dhe me bordin, nëse kërkohet.

Përveç auditimit të brendshëm dhe funksioneve të rrezikut, funksioni i pajtueshmërisë duhet të identifikojë, dokumentojë dhe vlerësojë në mënyrë proaktive rreziqet e pajtueshmërisë.

Bordi i drejtorëve është përgjegjës të sigurojë që ekziston një politikë e shkruar e pajtueshmërisë dhe se zbatimi i saj është në përputhje me strategjinë e menaxhimit të rrezikut.

¹⁹ Këto raporte do të përfshijnë një vlerësim të sistemit të kontrollit të brendshëm të Kompanisë dhe opinionin përfundimtar, rekomandimet në mënyrë ideale duhet të lëshohen në baza tremujore.

²⁰ Për shembull, nuk rekomandohet të kombinohen pozita e zyrtarit të riskut dhe zyrtarit ligjor ose të kërkohet që zyrtari i riskut të raportojë në emër të zyrtarit ligjor.

Kapitulli III. Struktura dhe Përgjegjësitë e Bordit

Një nga të drejtat kryesore të aksionarëve është emërimi i drejtorëve dhe përcaktimi i kompetencave të bordit. Bordi është një nga organet më të fuqishme të qeverisjes, prandaj detyra kryesore e tij është mbikëqyrja e zbatimit të kodeve dhe rregulloreve të qeverisjes së korporatave. Një kornizë qeverisëse duhet të përcaktojë në mënyrë formale strukturën e bordit, përfshirë madhësinë, përbërjen dhe procesin me të cilin drejtorët emërohen në bord.

Së bashku me strategjinë drejtuese të korporatave, bordi është kryesisht përgjegjës për rishikimin dhe udhëzimin e strategjisë së korporatave, planet kryesore të veprimit, politikat dhe procedurat e menaxhimit të riskut, buxhetet vjetore dhe planet e biznesit, shpenzimet kryesore kapitale, blerjet dhe zhvlerësimet. Ai është gjithashtu përgjegjës për mbikëqyrjen e administrimit të riskut dhe sistemeve të pajtueshmërisë të krijuara për të siguruar që korporata i bindet ligjeve në fuqi.

Bordi ka për detyrë të veprojë në interes të aksionarëve dhe duhet të trajtojë në mënyrë të drejtë interesat e palëve të interesit, duke përfshirë ato të punonjësve, kreditorëve, klientëve, furnitorëve dhe komuniteteve lokale. Bordeve u kërkohet në mënyrë të vazhdueshme të bëjnë shkëmbime të ideve komplekse, t'i kushtojnë kohë të konsiderueshme ekzekutimit të detyrave të tyre dhe të raportojnë tek aksionaret për performancën e ndërmarrjes.

Të kesh një kornizë të qartë dhe efektive është thelbësore për mbikëqyrjen e aktiviteteve të korporatave, duke përfshirë performancën e menaxhmentit, realizimin e objektivave në mënyrë që aksionarët të marrin raportim adekuat dhe që auditorët të kryejnë përgjegjësitë e tyre me kujdesin e duhur dhe pa konflikt interesi. Një bord efektiv duhet të nxitet vazhdimisht nga Kryetari i tij për t'u siguruar që ka njohuri dhe burime për të adresuar sfidat e korporatave.

Ky seksion i Kodit adreson praktikën më të mira në strukturimin e një bordi efektiv, duke siguruar që ai të menaxhojë konfliktet e interesit dhe të ekuilibrojë shkëmbimet komplekse në mes të përfitimeve dhe vlerësimeve të palëve të interesit. Veçanërisht, ky seksion adreson detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit, praktikën më të mira të pavarësisë së bordit, strukturën dhe përbërjen e bordit, komiteteve të tij, dhe mekanizmat për të vlerësuar dhe përmirësuar efikasitetin e bordit në baza të vazhdueshme.

IIIA. Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit

Është me rëndësi kritike që anëtarët e bordit duhet të jenë në gjendje të angazhohen në mënyrë efektive ndaj përgjegjësive të tyre dhe të dedikojnë kohë të mjaftueshme ushtrimit të detyrave të tyre.

Secili anëtar i bordit i detyrohet ndërmarrjes fiduciare dhe aksionarëve të saj që do të thotë se ai/ajo duhet të veprojë mbi një bazë plotësisht të informuar, me mirëbesim dhe me kujdesin e duhur.²¹

Anëtarët e bordit duhet të shmangin çdo rrethanë që mund të vendosë objektivitetin e tyre në rrezik ose që mund të rrezikojë aftësinë e tyre për t'i kushtuar kohë të mjaftueshme përgjegjësive të tyre të bordit.

²¹ Referojuni Nenit 258 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare i cili përcakton më tej detyrën e kujdesit dhe besnikërisë.

Në praktikë, anëtarët e bordit duhet të marrin në konsideratë (parasysh) se si përgjegjësitë e tyre ekzekutive dhe jo-ekzekutive mund të ndikojnë në përkushtimin dhe pavarësinë e tyre.

Nëse vendimet e bordit mund të ndikojnë ndryshe tek aksionarët, bordi duhet të trajtojë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë të gjithë aksionarët.

Veçanërisht, drejtorëve të emëruar nga një aksionar specifik duhet për t'ju përkujtuar detyrimi që kanë ndaj të gjithë aksionarëve si kolektiv.²²

Nga Bordet pritet që ti kushtojnë vëmendje dhe në mënyrë të drejte të merren me interesat e palëve të interesit duke përfshirë ato të punonjësve, kreditorëve, klientëve, furnitorëve dhe komuniteteve lokale.

IIIB. Struktura e bordit dhe komiteteve të tij

Bordi përmban numër të mjaftueshëm dhe balancim midis drejtorëve ekzekutivë dhe joekzekutivë, për t'i mundësuar atij të kryejë përgjegjësitë e tij me zell dhe kujdes.

Kriteret në lidhje me kualifikimet e anëtarëve të bordit dhe pavarësinë përshkruhen në kodin e qeverisjes korporative të kompanisë ose statutin e kompanisë.²³

Madhësia e bordit përcaktohet në bazë të madhësisë dhe kompleksitetit të kompanisë, strukturës së aksionarëve të saj dhe nevojës për ekspertizë të larmishme teknike.

Rekomandohet që bordi të përbëhet nga jo më pak se 5 drejtorë, nga të cilët shumica duhet të jenë drejtorë të pavarur, jo-ekzekutivë .

Anëtarët e bordit zgjedhen nga aksionarët për një periudhë 4 vjeçare, të rinovueshme deri në 3 herë, nëse miratohet nga vota e aksionarit. Aksionarët mund të jenë në gjendje të përdorin votimin kumulativ për të votuar për një kandidat të bordit.

Kompanitë nominojnë dhe emërojnë një numër të mjaftueshëm të drejtorëve të pavarur të cilët përbëjnë jo më pak se një të tretën e bordit dhe duke e drejtuar secilin komision të bordit nga një anëtar i pavarur i bordit.

Në ndërmarrjet me më shumë se dyqind e pesëdhjetë (250) aksionarë, të paktën 3 drejtorë të pavarur duhet të emërohen sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

²² Në kompanitë pjesë e një grupi, ku mund të ekzistojnë borde të veçanta, detyra e besnikërisë është ndaj bordit në të cilin ai / ajo është anëtar.

²³ Sipas nenit 175 të Ligjit të Kosovës për Shoqëritë Tregtare, statuti i kompanisë mund të parashikojë që bordi të miratojë me shkrim rregulla për qeverisjen korporative që mbulojnë çështje të tilla si standardet për kualifikimin dhe pavarësinë e drejtorit, përgjegjësitë e drejtorëve duke përfshirë pjesëmarrjen në takime, dilijencën në rishikimin e materialeve dhe rregullave të botimit dhe rishikimit të konfliktit të interesit, politikën e kompensimit të drejtorëve, planifikimin e vazhdueshëm si për drejtorët dhe zyrtarët, ashtu edhe për çështje të tjera të qeverisjes korporative që vlerësohen si të përshtatshme.

Në ndërmarrjet me njëqind (100) ose më shumë aksionarë, anëtarët e familjes së të punësuarve nuk mund të përbëjnë shumicën e bordit sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Konsiderohet si një praktikë e mirë të caktohet një drejtor Udhëheqës i pavarur, me kompetenca të veçanta për të kërkuar informacion nga menaxhmenti dhe për të udhëhequr diskutimin midis drejtorëve të pavarur.

Preferohet që bordi të drejtohet nga një drejtor i pavarur dhe rekomandohet fuqimisht që rolet e Kryeshefit ekzekutiv dhe Kryesuesit të mbahen të ndara.

Në masën që ekzistojnë komitetet e bordit, secili duhet të drejtohet nga një anëtar i bordit i cili nuk është kryesues i një komiteti tjetër dhe preferohet të jetë një drejtor i pavarur.

Bordi përfshin ekspertizë të larmishme në sektorin financiar, operacional, të riskut, qeverisjes dhe fushave të tjera të rëndësishme për biznesin e kompanisë.

Po ashtu rekomandohet që bordet të kenë përfaqësim gjinor, me synimin që të përfshijnë të paktën një anëtare të gjinisë femërore të përfaqësuar në bord.

Kryesuesi i Bordit, që do të zgjidhet midis anëtarëve të bordit, lehtëson diskutimet në takimet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të bordit dhe siguronë që përfaqësuesit e bordit të kenë aftësitë dhe pavarësinë e duhur.

Bordet mund të konsiderojnë emërimin e një Zëvendëskryeuesi midis anëtarëve të bordit për të lehtësuar vazhdimësinë e punës në rast se Kryesuesi është përkohësisht i padisponueshëm për të kryer detyrat e tij/saj.

Nëse kontrata e një anëtari të bordit përfundon ose ai/ajo jep dorëheqjen me vullnetin e tij/saj, kompania regjistron arsyet për ta bërë këtë në procesverbalin e takimit të bordit ku miratohet ky vendim.

Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, procesverbalet e takimit të bordit përgatiten jo më vonë se 3 ditë pas datës së takimit dhe nënshkruhen nga Kryesuesi (ose një drejtor tjetër) i cili kryeson takimin dhe Sekretari i Kompanisë (ose personi) i cili vepron si i tillë në këtë takim të bordit).

IIIC. Përbërja dhe struktura e komiteteve të bordit

Për të kryer përgjegjësitë e tyre në mënyrë të përshtatshme, bordet themelojnë komitetet e bordit, duke përfshirë Auditimin, Menaxhimin e Riskut dhe Qeverisjen.²⁴ Komitetet shtesë mund të themelohen sipas kërkesës.

Komitetet e bordit përfshijnë ekspertizën përkatëse dhe mund të kërkojnë të marrin ekspertizë të jashtme kur është e nevojshme. Nuk rekomandohet të ftohen individë që nuk janë anëtarë të bordit e të jenë anëtarë të komiteteve të tij.

²⁴ Komiteti i Qeverisjes mund të quhet gjithashtu një Komitet i Shpërblimit dhe Nominimit; megjithatë është propozuar që ky Komitet të ketë një detyrë më të gjerë se emërimi dhe kompensimi i bordit dhe ekzekutivëve.

Rekomandohet që drejtorët ekzekutivë të përbëjnë jo më shumë se gjysmën e bordit dhe që pjesëmarrja e tyre në komitetet e auditimit dhe qeverisjes në veçanti është e kufizuar.

Komitetet e bordit kanë ekspertizën e specializuar në fushën për të cilën ata kanë një përgjegjësi të veçantë dhe i raportojnë bordit për aktivitetet, rezultatet dhe përfundimet e tyre.

Për këtë qëllim, të paktën një anëtar i Komitetit të Auditimit duhet të ketë ekspertizë financiare, të paktën një anëtar i Komitetit për Menaxhim të Riskut duhet të ketë ekspertizë së riskut dhe të paktën një anëtar me ekspertizë të Qeverisjes Korporative.

Secili komision i bordit përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë, pjesëmarrja e tyre në Komitet kufizohet në kohëzgjatjen e mandatit të tyre.

Preferohet që anëtarët e një komiteti të bordit të mos jenë anëtarë të ndonjë komiteti tjetër.

Komiteti i Qeverisjes Korporative (ose Komiteti për Staf dhe Shpërblime) emëron drejtues të lartë dhe përcakton shpërblimin e tyre në përputhje me performancën afatgjatë të korporatës dhe interesin e aksionarëve.²⁵

Qeverisja Korporative (ose Komiteti i për Staf dhe Shpërblime) ka një përgjegjësi të veçantë për mbikëqyrjen e të gjitha çështjeve të qeverisjes në kompani, veçanërisht duke siguruar që kodi i qeverisjes korporative të kompanisë, statuti i kompanisë, matrica e autoritetit dhe dokumente të tjera përkatëse të jenë të përditësuara dhe të pasqyrojnë praktikën më të mirë.

Ky komitet gjithashtu ka përgjegjësinë përfundimtare për rishikimin dhe lëshimin e Deklaratës së Qeverisjes Korporative për të qenë pjesë e raportit vjetor, ku shpjegohet pajtueshmëria me këtë Kod.

IIID. Mbajtja e takimeve të bordit

Bordi dhe komitetet e tij marrin vendimet e tyre me një shumicë të thjeshtë, e cila do të përbëjë një kuorum. Kjo mund të lehtësohet duke pasur një numër tek të anëtarëve të Komitetit.

Kompanitë synojnë të mbajnë jo më pak se katër takime të bordit në vit, personalisht ose me mjete të tjera (nëse takimet fizike janë sfiduese).

Komitetet e bordit rekomandohen gjithashtu të takohen në baza tremujore dhe përcaktojnë një frekuencë të përshtatshme të takimeve.

Roli i Kryesuesit dhe puna e bordit dhe komiteteve të tij mund të mbështetet nga një Sekretar i Korporatës (d.m.th. sekretari i bordit).

Konsiderohet praktikë e mirë e qeverisjes korporative që vendimet e bordit, duke përfshirë çdo mendim mospajtues, të regjistrohet në procesverbalin e takimeve të bordit dhe të dokumentohet nga Sekretari i Korporatës ose një ekuivalent i tij.

²⁵ Nëse është e nevojshme, ai mund të përdorë ndihmën e palës së tretë për të përcaktuar shpërblimin e përshtatshëm.

Në ndërmarrjet e mëdha, konsiderohet praktika më e mirë që roli i Sekretarit të Korporatës të mos kombinohet me një rol tjetër.

Sekretari i Korporatës duhet të ketë ekspertizën e nevojshme ligjore (të paktën provimin e jurisprudencës) dhe qeverisëse për të kryer funksionet e tij/saj duke mos qene anëtar i bordit.

III.E. Rritja e efektivitetit të bordit

Vlerësimet e bordit do të ndihmojnë në vlerësimin e efikasitetit të bordit dhe nxjerrjen në pah të boshllëqeve të nevojshme për sa i përket aftësive të bordit dhe çështjeve në dinamikën e ndërveprimeve të bordit.

Rekomandohet që vlerësime të tilla të kryhen të paktën një herë në dy vjet, duke përdorur një metodologji dhe qasje që do të përcaktohet nga Kryesuesi i Bordit.

Kryesuesi i Bordit, duke përdorur vlerësimet e bordit dhe diskutimet me anëtarët e bordit synon të zhvillojë kapacitetet kolektive dhe individuale të bordit duke ofruar trajnime shtesë për temat përkatëse.

Në varësi të disponueshmërisë së buxhetit, anëtarët e bordit janë në gjendje të kërkojnë ekspertizë teknike shtesë (juridike, financiare, burime njerëzore, etj.) që mund t'u mundësojë atyre të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efektive.²⁶

Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare disa transaksione të rëndësishme kërkojnë që bordet të marrin mendime/vlerësime të palëve të treta të cilat mbulohen nga buxheti.

²⁶ Për shembull, bordi mund të kërkojë nga zyrtarët e burimeve njerëzore që t'ju ofrojnë bazën ligjore për kompensimin e ekspertëve të angazhuar.

Kapitulli IV. Shpalosja e informacioneve dhe transparenca

Shpalosja e materialit të informatave financiare dhe jo-financiare është një shtyllë themelore e qeverisjes së mirë, duke sinjalizuar transparencën e korporatës ndaj aksionarëve dhe palëve të interesit. Aksionarët dhe investitorët e mundshëm kërkojnë qasje në informacion të rregullt, të besueshëm dhe të krahasueshëm për ta për të vlerësuar menaxhimin dhe për të marrë vendime të bazuara në informata në lidhje me vlerësimin e korporatave. Shpalosja e plotë që promovon transparencën është thelbësore për aftësinë e aksionarit për të monitoruar kompanitë dhe është thelbësore për aftësinë e tyre për të ushtruar të drejtat e tyre mbi një bazë të informuar.

Në të kundërt, shpalosja jo e plotë dhe praktikat jotransparente mund të kontribuojnë në sjellje joetike dhe në humbjen e integritetit të tregut me një kosto të madhe, jo vetëm për kompaninë dhe aksionarët e saj, por edhe për ekonominë në tërësi. Shpalosja jo e plotë gjithashtu mund të ndikojë negativisht në kompani të veçanta duke rritur, për shembull, koston e kapitalit dhe duke ndikuar negativisht në reputacionin e kapitalit të kompanisë me klientët dhe furnitorët.

Në të njëjtën kohë, kërkesat për shpalosje nuk duhet të vendosin barra të paarsyeshme administrative ose të koston mbi ndërmarrjet. Nga kompanitë nuk pritet të shpalosin informacione që mund të rrezikojnë pozicionin e tyre konkurrues. Shpalosja publike kërkohet në bazë vjetore, megjithëse kompanitë mund të kenë nevojë të bëjnë shpalosje periodike mbi çështjet materiale dhe shpalosje të tjera vullnetare sipas nevojës.

Shpalosja transparente e informacioneve duhet të përfshijë materialin e informatave financiare dhe jo-financiare për çështjet e korporatave, të përgatitura nga menaxhmenti dhe të aprovuara nga bordi. Ky kapitull ofron udhëzime se si kompanitë mund të përmirësojnë cilësinë e shpalosjes së tyre financiare dhe jo-financiare. Ai gjithashtu siguron një tregues të përmbajtjes së Deklaratës së Qeverisjes Korporative që kompanitë duhet të publikojnë në bazë vjetore.

IVA. Qasja e aksionarit në informacione

Kompanitë përdorin metodat më efektive për të komunikuar me aksionarët dhe nuk duhet të bëjnë dallime midis aksionarëve në lidhje me sigurimin e informacionit.

Kompanitë këshillohen të ofrojnë informacione shpjeguese të qarta, adekuate dhe të krahasueshme, duke adresuar të gjitha zhvillimet materiale financiare dhe jo-financiare në Këshillin e Kosovës për Raportim Financiar (KKRF).

Të gjitha organizatat e regjistruara të biznesit (përveç Bankës Qendrore dhe organizatave të rregulluara nga ajo) duhet të paraqesin në Këshillin e Kosovës për Raportim Financiar (KKRF) pasqyrat e tyre vjetore financiare.²⁷

Bordet dhe drejtuesit e lartë këshillohen të referohen në dispozitat përkatëse të përfshira në Ligjin e vitit 2018 për Kontabilitetin, Raportimin Financiar dhe Auditimin në lidhje me shpalosjen dhe transparencën.

²⁷ Sipas nenit 18 të Ligjit për Kontabilitet dhe Raportim Financiar, kjo do të përfshijë pasqyrat financiare të konsoliduara, raportin e menaxhmentit, raportin e konsoliduar të menaxhmentit dhe raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare, përkatësisht raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të konsoliduara.

Përveç regjistrimit në KKRF, raportet vjetore dhe njoftimet materiale lëshohen në faqet e internetit të korporatave dhe i komunikohen drejtpërdrejt aksionerëve kryesorë.

Është e rëndësishme të përmendet se komunikimi brenda korporatave nuk privilegjon asnjë aksionar, ku të gjithëve u jepet qasje e barabartë në informacion.

Kompanitë duhet të zbulojnë strukturën e tyre të aksionarëve, veçanërisht çdo aksionar përfitues me aksione të kapitalit që tejkalon 5%. Çdo ndryshim i rëndësishëm në strukturën e pronësisë duhet t'i komunikohet aksionarëve.

IVB. Deklarata e qeverisjes korporative

Sipas Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (neni 7), ndërmarrjeve të mëdha u kërkohet të shtojnë një deklaratë të pajtueshmërisë, diskutimin, analizën e menaxhimit dhe një Deklaratë të Qeverisjes Korporative.²⁸

Megjithëse lista më poshtë nuk është shteruese, Deklarata e Qeverisjes Korporative, që do të miratohet nga bordi, përfshin elementët e mëposhtëm:

- Përbërja e bordit dhe komiteteve, si dhe pavarësia e tyre
- Vendimet kryesore të miratuara nga bordi gjatë vitit, dhe çdo arsytim të kërkuar
- Numri i takimeve të komitetit të bordit dhe nivelet e pjesëmarrjes në këto takime
- Vlerësimi i bordit për rreziqet kryesore, menaxhimin e tyre dhe mënyrën se si ato mund të ndikojnë në punët e kompanisë
- Informacione mbi emërimin e auditorit të jashtëm
- Informacione mbi mbikëqyrjen e funksionit të auditimit të brendshëm
- Mbikëqyrja e Bordit të drejtuesve të lartë dhe pikëpamja e tij mbi planifikimin e trashëgimisë së korporatave
- Shpërblimi i bordit dhe drejtuesve të lartë, duke përfshirë çdo skemë të kapitalit²⁹
- Çdo veprim i paligjshëm, jo etik që mund të ndikojë materialisht në operacionet e kompanisë
- Rezultatet e vlerësimeve të bordit dhe veprimet konkrete në të cilat këto mund të kenë rezultuar
- Informacione mbi çdo transaksion domethënës dhe çdo transaksion të palëve të ndërlidhura dhe proceset për aprovimin e tyre

Çdo devijim nga ky Kod, duhet të arsyetohet dhe të adresohet në Deklaratën e Qeverisjes Korporative në formën "përputh-ose-shpjego" në lidhje me këtë Kod.

²⁸ Sipas nenit 7 të Ligjit, kjo duhet të përfshijë elementet e mëposhtme: të gjitha informacionet në lidhje me praktikën e qeverisjes korporative, përshkrimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e rrezikut në lidhje me procesin e raportimit financiar, përbërjen dhe funksionimin e organeve menaxheriale, mbikëqyrëse dhe komitetet e tyre.

²⁹ Në planin ndërkombëtar, konsiderohet si praktikë e mirë për bordet për të zhvilluar dhe publikuar një deklaratë të politikës së shpërblimit për anëtarët e bordit dhe drejtuesit kryesorë.

Sipas rregulloreve përkatëse të BE-së, entitetet e interesit publik me më shumë se 500 punonjës përfshijnë në Deklaratën e tyre të Qeverisjes Korporative, informacione jo-financiare në lidhje me çështjet mjedisore, çështjet shoqërore dhe të lidhura me punonjësit, respektimin e të drejtave të njeriut, çështjet anti-korrupsion.³⁰

Kompanitë synojnë të komunikojnë rreth ndikimit të tyre mjedisor dhe social, duke miratuar indikatorët kyç të krahasueshëm të performancës që i referohen standardeve të pranuar ndërkombëtarisht, siç janë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

IVC. Marrëdhëniet me aksionarët

Kompanitë me aksionarë të huaj, për aq sa është e mundur, synojnë të sigurojnë komunikim në gjuhë të huaja përkatëse, për t'i lejuar ata të kenë qasje të lehtë në raportimin e korporatave.

Emërimi i një zyrtari për marrëdhënie me investitorët konsiderohet si praktikë e mirë për kompanitë me një bazë të madhe aksionarësh ose ato të listuara në tregjet e kapitalit publik.

Kompanitë këshillohen të caktojnë një zëdhënës për të komunikuar publikisht me autoritetet, aksionarët dhe publikun përmes mediave tradicionale, në internet dhe përmes mediave sociale sipas nevojës.

Nga ana tjetër, drejtuesit e tjerë dhe anëtarët e bordit të kompanisë abstenojnë nga bërja e deklaratave publike në emër të kompanisë që mund të ndikojë në vlerësimin e kompanisë.

³⁰ Për tekstin e plotë të rregullores, ju lutemi referojuni: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/PE-47-2014-INIT/en/pdf>

Kapitulli V. Etika dhe strukturat dhe praktikat e integritetit

Asnjë kornizë e qeverisjes korporative nuk mund të jetë efektive në mungesë të etikës së duhur dhe politikave të integritetit dhe zbatimit të tyre. Bordi vendos rregullat për organizatën, duke përfshirë proceset dhe procedurat e duhura të integritetit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Bordi ka përgjegjësinë përfundimtare për të siguruar që qeverisja kryesore dhe rreziqet e integritetit adresohen përmes një kornize etike dhe integriteti.

Korniza e etikës dhe integritetit duhet të përfshijë politika dhe procedura që merren me anti-ryshfetin, sinjalizimin dhe adresim të situatave të konfliktit të interesit. Politikat e etikës dhe integritetit duhet të adresojnë praktikën në nivelin e bordit, drejtuesëve të lartë dhe punonjësëve, si dhe bashkëveprimet e tyre me palët e treta. Si të tillë, ata duhet të adresojnë se si anëtarët e bordit duhet të sillen në situata të konfliktit të interesit, për shembull, duke kërkuar që anëtarët e bordit të përfshirë në konflikt të abstenojnë nga pjesëmarrja në proceset e vendimmarrjes.

Ata gjithashtu duhet të adresojnë pritjet e sjelljes në nivelin e menaxhmentit të lartë dhe punonjësëve. Një politikë etike që zhvillohet nga menaxhmenti dhe miratohet nga bordi ose komiteti i tij, mund të sigurojë një bazë solide për komunikimin e këtyre pritjeve. Politikat shpesh, të tilla si politika sinjalizuese, ose politika anti-korrupsion mund të përforcojnë kornizën etike brenda korporatës.

Në fund, një standard i lartë i etikës dhe integritetit u ofron aksionarëve siguri të investimeve të tyre dhe palëve të interesit për ndikim pozitiv shoqëror dhe mjedisor. Përkundrazi, praktikën joetike dhe të paligjshme nga zyrtarët e korporatave jo vetëm që mund të shkelin të drejtat e palëve të interesit, por gjithashtu mund të dëmtojnë kompaninë dhe aksionarët e saj për sa i përket efekteve të reputacionit dhe një rreziku në rritje të detyrimeve të ardhshme financiare.

Ky kapitull adreson rolin e bordit dhe menaxhmentit në promovimin e një kulture etike, adresimin e situatave të konfliktit të interesit, si dhe rishikimin, miratimin e palëve të lidhura dhe transaksione të tjera me rrezik të lartë. Qëllimi i këtij seksioni të Kodit është të sigurojë udhëzime praktike se si mund të nxitet një kulturë etike brenda organizatave dhe si mund të forcohet besimi i aksionarëve dhe palëve të interesit.

VA. Roli i bordit dhe menaxhimit në promovimin e etikës

Menaxhmenti përgatit dhe azhurnon në mënyrë periodike politikën në lidhje me pajtueshmërinë, integritetin dhe anti-korrupsionin, që synojnë të adresojnë rreziqet kryesore me të cilat përballlet kompania.

Komiteti i Qeverisjes Korporative brenda Bordit është përgjegjës për miratimin dhe rishikimin periodik të këtyre politikave.

Bordi siguron që burimet e duhura t'i dedikohen funksioneve të integritetit, pajtueshmërisë dhe që kontrollat e përshtatshme ekzistojnë për të parandaluar mashtrimet e korporatave.

Akterët, duke përfshirë punonjësit individualë dhe organet e tyre përfaqësuese, duhet të jenë në gjendje të komunikojnë lirshëm shqetësimet e tyre në lidhje me praktikën e paligjshme ose joetike të bordit dhe të autoritetet publike kompetente.

Aktiviteti i sinjalizimit nga palët e interesit duhet të lejohet dhe të lehtësojë raportimin e praktikave joetike/të paligjshme, dhe kompanitë do të angazhohen për t'i hetuar ato në mënyrë të përshtatshme dhe për të mbrojtur akterët nga hakmarrja.

VB. Menaxhimi i konflikteve të interesit

Kryetari verifikon dhe konfirmon që anëtarët e bordit nuk kanë ndonjë konflikt interesi kur marrin përsipër detyrat e tyre.

Secili anëtar i bordit duhet të nënshkruaj një deklaratë që konfirmon mungesën e konfliktit të interesit në fillim të mandatit të tij/saj.³¹

Anëtarëve të bordit dhe drejtuesve kryesorë duhet t'u kërkohet të zbulojnë nëse ata, drejtpërdrejt, indirekt ose në emër të palëve të treta, kanë një interes material në ndonjë transaksion ose çështje që ndikon drejtpërdrejt në kompani.

Situatat e konfliktit të interesit në nivel punonjësish, të menaxhmentit të lartë dhe të bordit duhet të adresohen në politikën e etikës së kompanisë ose ekuivalentin e saj.

Transaksionet që përbëjnë konflikt interesi për anëtarët e ekzekutivit dhe/ose bordit siç përcaktohet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare miratohen nga shumica e bordit, ku anëtari i bordit i përfshirë në konflikt abstenon nga votimi.³²

VC. Transaksionet e palëve të ndërlidhura dhe me rrezik të lartë

Transaksionet e palëve të ndërlidhura duhet të miratohen dhe ekzekutohen në një mënyrë që sigurojnë një menaxhim të duhur të konfliktit të interesit dhe interesave të korporatave dhe aksionarëve.

Transaksionet materiale të palëve të ndërlidhura dhe mënyra se si ato janë aprovuar shpalosen në raportin vjetor financiar.

Transaksionet materiale të palëve të ndërlidhura duhet t'i nënshtrohen protokolleve shtesë të miratimit nga bordi ose një komitet i tij, ku çdo anëtari të bordit, të përfshirë në konflikt i kërkohet të abstenojë.

Rreziqet kritike të qeverisjes siç janë prokurimi, aktiviteti i import/eksportit dhe kontraktimi me Qeverinë (si dhe rreziqet specifike të sektorit) duhet t'i nënshtrohen rishikimit shtesë nga i auditimit të brendshëm dhe Komiteti i Auditimit të Bordit.

Aksionarët pakicë duhet të mbrohen nga veprimet abuzive nga, ose në interes të, aksionarëve kontrollues që veprojnë direkt ose indirekt.

³¹ Anëtarëve të bordit duhet t'u kërkohet të njoftojnë Kryesuesin e bordit për çdo ndryshim në aktivitetet e tyre ekzekutive ose jo-ekzekutive, aksionet ose interesat të tjerë që mund të ndikojnë në këtë deklaratë.

³² Ju lutemi referojuni neneve 258-260 në Ligjin për Shoqëritë Tregtare për informacion të mëtejshëm në lidhje me mënyrën e miratimit të këtyre transaksioneve.

Si të tilla, të gjitha transaksionet e rëndësishme me aksionarët kontrollues i nënshtrohen Miratimit të Komitetit të Auditimit.

Për më tepër, kujtohet se transaksionet kryesore³³ siç përcaktohet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare miratohen nga të paktën dy të tretat (2/3) e aksionareve që kanë të drejtë të votojnë për transaksionin në Kuvendin e aksionarëve.

³³ Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare “transaksion i madh” do të thotë një transaksion ose një seri e ndërlidhur e transaksioneve ku përfshihet blerja apo përvetësimi, shitja, vënia peng, apo hipotekimi i pronës, të drejtave pronësore apo të drejtave të tjera që kanë vlerë monetare dhe vlera e të cilave në kohën e marrjes së vendimit për kryerjen e transaksionit nga shoqëria përbën njëzet përqind (20%) apo më shumë të vlerës së përgjithshme të aseteve.